

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Çmimet rekord të karburantit tronditin BE-në, rriten thirrjet për taksë mbi fitimet e kompanive të energjisë - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/cmimet-rekord-te-karburantit-tronditin-be-ne-rriten-thirrjet-per-takse-mbi-fitimet-e-kompanive-te-energji-se/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 21:25:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 21:22:13 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a1739d2e6444869d6816e0fc4c9695618e67e5433dc8dcace4fd862c2c6d100a
TEKSTI	7194f34d3b48ad53340ad59a030e0d619fcafc01dac758b67fc7efb574415b14
PAMJA	d9f2b51bba9f175756a57f7fd986a859cc1ce285087e08aabe37d385c6ce8a84

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1d68a2c3984741e24b2465cf4b55a984b43a1ba7b4b3307c7be2925528392315
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	29fcf9b8b5be0730a486ab00126645ea98174f049f7b6a8e27a114acaae60ed3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1d68a2c3984741e24b2465cf4b55a984b43a1ba7b4b3307c7be2925528392315>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Çmimet rekord të karburantit tronditin BE-në, rriten thirrjet për taksë mbi fitimet e kompanive të energjisë

by Bota Bota — September 18, 2026 in Aktualitet

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Çmimet e karburantit dhe gazit në Evropë kanë arritur nivele rekord, duke shtuar presionin mbi qeveritë e Bashkimit Evropian për të ndërhyrë.

Gjermania ka kërkuar nga Komisioni Evropian të shqyrtojë mundësinë e një takse mbi fitimet e tepërta të kompanive të naftës dhe energjisë, ndërsa disa shtete anëtare kanë ndërmarrë masa për të zbutur koston për qytetarët dhe bizneset.

Ministri gjerman i Financave, Lars Klingbeil, i kërkoj Komisionit Evropian të paraqesë propozime për mënyrën se si mund të tatohen fitimet e kompanive të naftës, duke argumentuar se disa prej tyre po përfitojnë ndjeshëm nga rritja e çmimeve.

"Disa shtete anëtare kanë kërkuar modele për një kohë të gjatë", tha Klingbeil në takimin e ministrave të Financave të BE-së në Dublin, duke kërkuar që propozimet të paraqiten muajin e ardhshëm.

Komisioneri ekonomik i BE-së, Valdis Dombrovskis, deklaroi se Komisioni nuk ka aktualisht një plan për krijimin e një mekanizmi tatimor në nivel të gjithë BE-së, por tha se është i gatshëm të diskutojë çështjen. Sipas tij, shtetet anëtare kanë të drejtë të vendosin masa tatimore në nivel kombëtar.

Rritja e çmimeve të karburantit lidhet me tronditjet e reja në tregjet energjetike dhe pasiguritë për furnizimet ndërkombëtare.

Kontratat e ardhshme të naftës janë ngjitur sërish mbi 100 dollarë për fuçi, rreth 50% më shumë se para përshkallëzimit të luftës në Iran. Sulmet në rritje në Lindjen e Mesme kanë shtuar shqetësimet për rrugët e furnizimit, ndërsa tregjet e derivateve sinjalizojnë se çmimet mund të mbeten të larta në afat të shkurtër.

Në të gjithë BE-në, çmimi i benzinës është rritur rreth 24% krahasuar me një vit më parë, ndërsa nafta është shtrenjtuar me rreth 38%. Karburanti për avionë kushton më shumë se dyfishi i një viti më parë.

Edhe çmimet e gazit janë rritur ndjeshëm. Kontratat referencë po tregtohen rreth 81 euro për megavat-orë, rreth 150% më shumë se një vit më parë, ndërsa analistët nuk përjashtojnë një rritje të mëtejshme.

Në Gjermani, çmimi mesatar i naftës arriti 2.45 euro për litër, ndërsa benzina u ngjiti në një rekord prej 2.31 euro për litër, sipas ADAC, klubit më të madh automobilistik në vend.

Në Holandë, çmimet janë edhe më të larta. Benzina arriti rreth 2.73 euro për litër, ndërsa nafta u shit me një mesatare prej 2.78 euro për litër. Çmime rekord janë regjistruar gjithashtu për benzinën në Danimarkë dhe për naftën në Finlandë. Rritja e çmimeve është shndërruar në një çështje të rëndësishme të politikës së brendshme në disa prej ekonomive më të mëdha të BE-së.

TË FUNDIT

Çmimet rekord të karburantit tronditin BE-në, rriten thirrjet për taksë mbi fitimet e kompanive të energjisë

SEPTEMBER 18, 2026

"1,800 dollarë për të mbyllur llogaritë"! Kush fshihet pas sulmit ndaj protestuesve në Tiranë?

SEPTEMBER 18, 2026

Dhunë pas sfidës Vllaznia-Teuta, tifozët sulmojnë autobusin e klubit durrsak

SEPTEMBER 18, 2026

Tragjedi në Itali, 42-vjeçarja shqiptare përplasat për vdekje nga kamioni i mbetjeve, vajza 9-vjeçare pa gjithë skenën

SEPTEMBER 18, 2026

Protesta e 111-të mbyllet para Kryeministrit, qytetarët thirrje: Arrestoni Ramën!

SEPTEMBER 18, 2026

Gruaja simbol e eksodit të Kosovës: UÇK-ja na ndihmoi të shpëtonim

SEPTEMBER 18, 2026

Raporti tronditës/ Raiffeisen, banka që po financon makinerinë e luftës së Putin

SEPTEMBER 18, 2026

Këta janë tre të rinjtë që humbën jetën tragjikisht në Athinë

SEPTEMBER 18, 2026

9 alarmet e sigurisë ushqimore, produkte me salmonelë, toksina e kimikate në treg

SEPTEMBER 18, 2026

Një shpërthim, dhjetëra jetë të humbura: Çfarë ndodhi në xhaminë e Pakistanit?

SEPTEMBER 18, 2026

Shprehjet e asaj prej shprehjet e me te medha te 22.03.

Në Francë, Presidenti Emmanuel Macron u ka kërkuar ministrave të mobilizojnë qeverinë për të garantuar furnizimet dhe për të kufizuar ndikimin e rritjes së çmimeve të karburantit.

Qeveria franceze po përpiqet gjithashtu të sigurojë furnizime ndërkombëtare dhe ka bërë thirrje për një "rihapje paqësore" të ngushticës së Hormuzit, një prej rrugëve kryesore të transportit të naftës në botë.

Çmimet e larta kanë shkaktuar edhe protesta. Peshkatarët francezë bllokuan të enjten hyrjen në dy porte dhe një depo karburanti në jug të vendit. Nafta për peshkim është rritur në rreth 2.37 euro për litër, shumë pranë rekordit prej 2.38 eurosh.

Pas negociatave me qeverinë, protestuesit pranuan të heqin bllokat pasi iu prematuan kredi me interes zero për bizneset me probleme likuiditeti dhe masa mbështetëse të lidhura me ndryshimin e çmimeve të karburantit.

Kryeministri francez Sébastien Lecornu ka zgatur gjithashtu deri në fund të vitit subvencionet emergjente të karburantit për sektorët e bujqësisë, peshkimit dhe ndërtimit.

Në Itali, qeveria e Gorgia Meloni ka njoftuar masa për të lehtësuar barrën mbi drejtuesit e automjeteve.

Nga viti i ardhshëm pritet të hiqet taksa rrugore për rreth 14.5 milionë makina dhe motoçikleta, me një kosto prej më shumë se 2 miliardë eurosh. Masa vjen krahas uljes së taksës së naftës, e cila deri tani i ka kushtuar shtetit rreth 2.8 miliardë euro.

Spanja ka dyfishuar zbritjen e taksës për naftën, duke e çuar atë në 0.20 euro për litër nga 1 shtatori. Vendimi erdhi pasi çmimi i naftës u rrit me 15.7% vetëm gjatë korrikut.

Në Gjermani, kancelari Friedrich Merz ka premtuar masa të reja për të zbutur ndikimin e çmimeve rekord. Berlino kishte ulur përkohësisht taksat mbi karburantet për dy muaj gjatë majit, por masa përfundoi në një periudhë kur tensionet në Lindjen e Mesme po shtonin sërish çmimet.

Tags: karburantet

Previous Post

"1,800 dollarë për të mbyllur llogaritë"! Kush fshihet pas sulmit ndaj protestuesve në Tiranë?



Bota Bota

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencë dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

Aktualitet
OP-ED
Politike
Rajon
Showbiz
Sociale
Shëndet
Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin

0 SHARES



Skandali/Policia rrugore shoqëron kamionët e Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.